3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Termat e Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.....

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Formulari 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë
(në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					

Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt _____, është i pamiratur dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6 .

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohej nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

1. Qëllimi

Specifikimet teknike përcaktojnë punimet e mirëmbajtjes të cilat do të kryhen në Kopshtin Zoologjik të Tiranës, duke përfshirë ndërhyrjet strukturore dhe operacionale në elementet

drusore (trare, kolona), krasitjen dhe prerjen e pemëve në zonën përreth kafazeve të luanëve dhe tigrave, si dhe riparimin dhe rrethimin e pellgut. Qëllimi kryesor është të sigurohet një nivel i lartë sigurie për vizitorët (veçanërisht fëmijët), për stafin dhe për kafshët, si dhe të rikthehet funksionaliteti dhe estetika e hapësirave publike.

2. Baza ligjore dhe standardet

Punimet do të zhvillohen në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe standardet ndërkombëtare të zbatueshme për materialet dhe teknikat e përdorura. Referencat kryesore për këtë libër specifikimesh përfshijnë legjislacionin kombëtar për mbrojtjen e mjedisit dhe për sigurinë dhe shëndetin në punë, si dhe standardet teknike për veshje mbrojtëse dhe përgatitjen e sipërfaqeve.

Disa dokumente dhe standarde të përcaktuara si udhëzues në këtë libër:

- Ligji për mbrojtjen e mjedisit (Ligj Nr. 10431, datë 9.6.2011).
- Ligji për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë (Ligj Nr. 10237, datë 18.02.2010) dhe rregulloret në zbatim sipas Inspektoriatit të Punës.
- Standardet për sistemet mbrojtëse të veshjeve për dru
- Standardet për matjen e gloss-it të veshjeve (ISO 2813) dhe metodat e kontrollit vizual të sipërfaqeve (ISO 8501-1 për pastrimin e çelikut).

Punëdhënësi dhe kontraktori duhet të konsultojnë dokumentacionin ligjor të plotë para fillimit të punimeve dhe të respektojnë çdo VKM ose udhëzim vendor të Bashkisë Tiranë që lidhet me punimet në hapësira publike.

3. Përshkrimi i gjendjes aktuale

Nga inspektimi paraprak janë konstatuar dëmtime të ndryshme që kërkojnë ndërhyrje:

- Shtresë llaku e dëmtuar dhe nxirje lokale në trarë dhe kolona drusore; shfaqje njollash të lagështisë dhe prania e çarje sipërfaqësore.
- Degë dhe bimësi e tepruar pranë kafazeve kryesore (luanë, tigre) që mund të përdoret si rrugë arratisjeje ose të krijojnë rrezik për kafshët dhe vizitorët.
- Rrethimi i pellgut i amortizuar (shtylla të dobësuara, lidhje të kënaqshme, çarje bazamenti) dhe mungesë barrierash adekuate për fëmijët dhe shpendët.

Për secilën zonë rekomandohet realizimi i një inventari fotografik dhe një raporti inspektues përpara fillimit të punimeve, i cili do të bashkëngjitet raportit përfundimtar.

4. Përshkrimi teknik

Shërbimet do të kryhen në faza të ndara dhe të organizuara sipas bazës së mëposhtme:

4.1 Përgatitja e sipërfaqeve (trare, kolona drusore):

- Vlerësimi i gjendjes: inspektim i detajuar i çdo elementi, duke përfshirë ekzaminimin e lidhjeve, vrimave për kurthe uji dhe gjurmëve të insekteve për elementët drusorë.
- Pastrimi paraprak me furça të forta dhe ajër të kompresuar për të hequr pluhurin dhe papastërtitë e lirshme.

- Identifikimi i zonave ku kërkohet pastrim me mjet mekanik i fortë (poëer tool cleaning ose abrasive blasting për elementët metalikë).
- Përcaktimi i nivelit të pastrimit sipas tipit të materialit: për metalet e ekspozuara, përdorimi i gradës Sa 2½ (ISO 8501-1) rekomandohet kur kërkohet veshje me jetëgjatësi mesatare e të lartë.

4.2 Zmerilimi dhe metoda të pastrimit (druri dhe metal):

- Për elementët drusorë: përdorim i letër-zmerilëve P80–P180 për heqjen e shtresave të dëmtuara të llakut dhe për lëmuarjen e sipërfaqes, në varësi të gjendjes. Pas zmerilimit, duhet të fshihen mbetjet me leckë të lagur dhe të lihen të thahen plotësisht para aplikimit të primërit.
- Në rast përdorimi të produkteve kimike (degreasers, pastrues), materialet duhet të jenë të aprovuara për përdorim në ambiente me praninë e kafshëve dhe me minimumi mbetje kimike (shpëlarje të plota pas aplikimit).

4.3 Sistemet e veshjes (primër, llak, bojë)

- Zgjedhja e sistemit të veshjes do bëhet në bazë të kategorisë së korrozionit dhe kërkesave të qëndrueshmërisë sipas ISO 12944 (p.sh. C3 – C4 për mjedise urbane / mjedise me lagështi të ulët deri mesatare). Për aplikime në elementë metalikë të ekspozuar, përdorimi i një primri galvanizues (zinc-rich primer) dhe më pas një sistem polyuretanik ose akrilik poliuretanik për dy shtresa sipërfaqësore rekomandohet.

- Shtresë primer: aplikim i një shtrese primri sipas rekomandimeve të prodhuesit, synimi për të arritur ngjytjen optimale dhe mbrojtjen ndaj korrozionit (p.sh. primer me bazë epoksi ose zinc-rich për metalet).

- Shtresat e mbylljes: dy shtresa të llakut poliuretanik/akrilik me tharje të plotë; synohet një DFT përfundimtar në diapazon të përcaktuar nga prodhuesi (për sisteme standarde industriale DFT mund të jetë në rangun 80–200 µm varësisht kërkesave të qëndrueshmërisë). Referenca për zgjidhjen e sistemit dhe pritshmërinë e qëndrueshmërisë të jepet sipas ISO 12944.
- Aplikimi: mundësi aplikimi me furçë/rolë për zona të vogla dhe me spërkatje (airless spray) për zona të mëdha; çdo aplikim duhet të respektojë kohën e tharjes ndërmjet shtresave dhe temperaturat relative të punës (p.sh. temperatura ambientale >5°C dhe lagështi relative nën 80%, si rregull i përgjithshëm praktik).

Llak Poliuretani me Bazë Uji

1. Produktit

- **Tipi:** Llak poliuretani transparent, një-komponent, vetëlidhës, me bazë uji
- **Përdorimi:** Sipërfaqe druri të brendshme me trafiku intensiv (binaresh, shkallë, dysHEME druri, sipërfaqe të tjera me kalim të lartë)

- **Karakteristikat kryesore:**

- Rezistencë e lartë ndaj konsumit dhe gërvishtjeve
- Rezistencë ndaj shenjave të zeza (BHMR)
- I gatshëm për përdorim
- Disponueshëm në versionet: Glossy, Semi-glossy, Matt, Extra Matt, “Invisible Look”
- VOC i ulët: 35 g/l

2. Përgatitja e Sipërfaqes

- Mbush çarjet dhe hendekët me **filler me bazë uji ose bazë tretësirash**.
- Rrafshoni me letër gërryese **150 grit**
- Siguroni që sipërfaqja të jetë e pastër, e thatë dhe e lirë nga pluhuri dhe yndyrnat

3. Aplikimi i Llakut

- **Metodat e aplikimit:** Roller mikrofibër, Brush (penel), Spray (mund të hollohet 10% me ujë)
- **Shtresat:**
 1. Shtresa e parë – pas 6 orësh gërrysho me letër 220 grit
 2. Shtresa e dytë – shtresa e tretë vetëm nëse është e nevojshme, me gërrysh 180–220 grit
- **Opsionale:** Primer me bazë uji për sipërfaqe më të lëmuara dhe kohë më të shkurtër gërryshjeje
- Për sipërfaqe të mëdha ose temperatura të larta, mund të shtohet **5% ngadalësues tharjeje**

4. Aplikimit

- Temperatura: **>10 °C**
- Lagështia relative: 60%
- Mos e aplikoni mbi primer të tretësirave të tjera
- Versioni “Natur” nuk rekomandohet mbi dru të errët pa teste paraprake

5. Koha e Tharjes dhe Mbivendosjes

Proces	Koha e nevojshme
--------	------------------

Tharje pluhuri	30 min
----------------	--------

Prekshëm me dorë	1h 30 min
------------------	-----------

Mbivendoset	3–4 orë
-------------	---------

Gërryshimi i parë	6 orë
-------------------	-------

Konsum mesatar	12–14 m ² /l
----------------	-------------------------

6. Mirëmbajtja

- Pastrimi i rregullt: sapun neutral ose detergjent për drurin e trajtuar
- Mirëmbajtje periodike: emulsion llaku ose ëax

7. Siguria dhe Ruajtja

- Për përdorim profesional vetëm
- Ruajeni në paketim origjinal, të mbyllur, mbi 10 °C
- Afati i ruajtjes: 12 muaj
- Mbajtja larg ngrirjes dhe dritës së drejtpërdrejtë
- Pastrimi i mjeteve: sapun neutral dhe ujë

4.4 Krasitja dhe prerja e pemëve (procedura dhe masa mbrojtëse):

- Vlerësimi i arboristikës: para çdo ndërhyrjeje, një arborist (specialist pemësh) duhet të kryejë vlerësimin për shëndetin e pemëve, praninë e premtimeve për insekte/sëmundje dhe përfaqësimin e riskut dinamik për kafshët.
- Parimi i ndërhyrjeve: të preferohet prerja minimale e nevojshme për sigurinë (safety pruning) dhe të shmangët prerja e madhe (croën removal) që është traumatike për pemën. Prerjet e mëdha kryhen vetëm kur është e domosdoshme për sigurinë.
- Koordinimi me kafshët: punimet pranë kafazeve të luanit dhe tigrit duhet të kryhen vetëm në orare të lejuara dhe nën mbikëqyrje të stafit të kopshtit dhe të Veterinerit. Kur është e mundur, të planifikohen ndërhyrjet gjatë periudhave kur kafshët janë më pak aktive (p.sh. pasdreke) ose të transferohen në zona të sigurta brenda kopshtit kur procedurat kërkojnë zhurmë të madhe.
- Sezonaliteti dhe mbrojtja e shpendëve: krasitjet të shmangen gjatë periudhës së ndezjes (në Shqipëri, zakonisht mars–qershor për shumicën e shpendëve të vendit). Në rast se kryhet prerje gjatë kësaj periudhe, paraprakisht të verifikohet mungesa e foleve qetësuese.

4.5 Riparimi dhe rrethimi i pellgut (detaje strukturore):

- Inspektimi i bazamentit: kontroll i themeleve dhe bazamenteve të shtyllave ekzistuese; në rast deformimesh ose konsolidimi i tokës, projektuesi duhet të përcaktojë masat përforcuese (p.sh. betonim i shtyllave me beton klasë minimale C20/25).
- Projektimi i rrethimit: rrethimi duhet të sigurojë një pengesë fizike për fëmijët (lartësi të paktën 1.2 m, me rekomandim 1.2–1.5 m për zona me qarkullim të lartë të fëmijëve), derivuar sipas rrezikut dhe ndjeshmërisë së zoneve. Struktura mund të jetë metalike (profil çeliku galvanizuar me panele ose rrjetë) ose drusore të trajtuar me llak antikorroziv.
- Lidhjet dhe portat: portat e aksesit të jenë me mbyllje të sigurt me kapak sigurie për publikun dhe sisteme që lejojnë zjarrfikje/evakuim në rast emergjence.
- Mbrojtja e florës dhe faunës: gjatë punimeve të rrethimit të pellgut, të sigurohen masa për të mos futur ndotje në ujë (p.sh. përdorim i perdeve filteruese, rrjeta për kapjen e mbetjeve) dhe të parandalohen rrjedhjet e bojës ose kimikateve në ujë.

5. Materialet dhe specifikimet teknike

Të gjitha materialet duhet të jenë të reja, të certifikuara dhe të kenë deklarata përputhshmërie me normat përkatëse. Karakteristikat teknike minimale:

- Primer për metale: epoksi ose zinc-rich, me rezistencë kimike dhe aderim të lartë.
- Lliku mbyllës: poliuretanik ose akrilik poliuretanik, me rezistencë ndaj UV dhe lagështisë.
- Letrat zmerile: P80, P120, P180 sipas fazës së përgatitjes.
- Pjesët metalike: çelik i galvanizuar për profilin e rrethimit; trashësia minimale e metalit 2 mm për panelet mbajtëse.
- Produkte për pastrim: de-greasers biologjikisht të degradueshme, pa solvend të rrezikshëm në përqendrim të lartë, kur të jetë e mundur.

6. Organizimi i punishtës dhe logjistika

- Akses: vendosja e rrugëve të qarta të qasjes për automjetet e punës dhe zonave për magazinim materiale, të mbyllura dhe larg kafshëve.
- Magazinimi: materialet dhe kimikatet të ruhen në ambiente të mbyllura, të etiketuara dhe të vendosura nëpër rafta me kapacitet për spërkatje ose rrjedhje të paqëllimshme.
- Orari i punës: punimet me zhurmë të lartë duhet të kryhen në orare të kufizuara (p.sh. 09:00–17:00) dhe të koordinohen me stafin e kopshtit për të minimizuar stresin e kafshëve.
- Personeli: çdo grup pune duhet të përbëhet nga një përgjegjës pune, një mbikëqyrës teknik, një persona për sigurinë dhe ekipet operacionale.

7. Siguria në punë dhe mbrojtja e kafshëve

- Masa paraprake: para fillimit të punimeve duhet të merren lejet e nevojshme nga administrata e kopshtit, të certifikohen skemat e evakuimit dhe të vendosen sinjalistika dhe barrierë për publikun.

- Mbrojtja personale: punonjësit duhet të pajisen me helmetë, doreza, syze, maskë për pluhur/solvente dhe veshje vizive. Për punime në lartësi, përdorimi i rripave sigurie dhe sistemit të ankorimit është i detyruar.
- Mbrojtja e kafshëve: gjatë punimeve pranë kafazeve, duhet të garantohet që kafshët të mos kenë kontakt fizik me mjetet ose materialet e punës. Kur punimet e kërkojnë, kafshët duhet të mbyllen në vende të sigurta apo të largohet nga zona e veprimit sipas planit të kopshtit zoologjik.
- Procedurat emergjente: për çdo incident (lëndim, rrjedhje kimikate, dëmtim të rrethimit) të njoftohet menjëherë mbikëqyrësi teknik dhe spitali/odhara e urgjencës së kopshtit.

Referenca ligjore: Ligji Nr. 10237/2010 dhe rregulloret në zbatim për sigurinë në kantier dhe përdorimin e pajisjeve mbrojtëse.

8. Mbrojtja e mjedisit dhe trajtimi i mbetjeve

- Mbetjet e ngurta dhe të lëngëta: të gjitha mbetjet (druri i prerë, mbetjet metalike, kutitë e bojës) të depozitohen në mënyrë të ndarë dhe të dorëzohen në pika të miratuara nga Bashkia për riciklim ose asgjësim. Materialet kimike dhe bojërat e mbetura duhet të trajtohen si mbetje speciale në përputhje me legjislacionin për mjedisin (Ligji Nr. 10431/2011).
- Parandalimi i derdhjes në pellg: përdorimi i perdeve furçe dhe barriera të përkohshme për të parandaluar hyrjen e mbetjeve në ujën e pellgut gjatë punimeve.
- Zgjedhja e produkteve: preferimi i bojërave me përmbajtje të reduktuar VOC dhe produkteve që kanë deklarata mjedisore (eco-label) kur janë të disponueshme.

9. Kontrolli i cilësisë, testimet dhe pranimi

- Kontrolli vizual: pas secilës faze kryhet kontrolli vizual nga mbikëqyrësi teknik sipas kontrolleve të listës së parametrave (ngjitje, uniformitet, mungesë kollapsi/rrudhe).
- Matjet DFT: përdorimi i pajisjeve për matjen e trashësisë së filmit të thatë (DFT gauge) për të verifikuar qëllimin e trashësisë së sipërfaqes së aplikuar.
- Testet e aderimit: kryerja e testit të prerjes (cross-cut) dhe vlerësimi i rezultateve sipas udhëzimeve të prodhuesit (për referencë standardet e testimit të aderimit janë të njohura si ISO/EN për testet e prerjes).
- Matja e gloss-it (opsionale): për aplikimet ku nevojitet kontrolli estetik, matja e gloss-it do të bëhet sipas ISO 2813.
- Dokumentacioni i pranimi: procesverbal i punimeve, listë me fotot e punimeve "para-pas", dhe raport teknik i përfundimit.

10. Afatet, përgjegjësitë dhe dokumentacioni i dorëzueshëm

- Afatet: punimet parashikohen të kryhen brenda një periudhe të përafërt prej 30 ditësh pune, të ndara në faza (përgatitje, zmerilim, lyerje, prerje pemësh, riparim rrethimi).
- Përgjegjësitë: kontraktori përgjigjet për zbatimin teknik dhe sigurinë; mbikëqyrësi teknik nga institucioni pritës për verifikimin e punimeve; specialistët (veterinar, arborist) për koordinim në zonat me kafshë.

-
- Dorëzueshmëria: raport i plotë tekniko-administrativ me dokumentacion fotografik, procesverbale, certifikata materialesh dhe manuali i mirëmbajtjes.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT**Shërbimet që kërkohen:**

NR	KODI	EMËRTIMI	NJËSI A	SASIA
1	3.837/a	Rrethim rruge me rrjete teli	m2	80
2	2.694+An 1	Pastrim dhe lysterje e trareve dhe kolonave te drurit	m2	3,639
3	3.6+An 2	Krasitje dhe sistemim i pemeve	cope	8

Afatet e ekzekutimit: Afatet: punimet parashikohen të kryhen brenda një periudhe prej 30 ditësh pune, të ndara në faza (përgatitje, zmerilim, lysterje, prerje pemësh, riparim rrethimi).

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Ky relacion teknik ka për qëllim të përshkruajë punimet e mirëmbajtjes që do të kryhen në Kopshtin Zoologjik të Tiranës, duke përfshirë ndërhyrjet në trarë dhe kolona, krasitjen dhe prerjen e pemëve pranë kafazëve të luanëve dhe tigra, si dhe riparimin dhe rrethimin e pellgut. Qëllimi kryesor është të garantohen siguria e vizitorëve, stafi dhe kafshët, si dhe funksionaliteti dhe estetika e hapësirave të kopshtit.

Punimet sigurojnë riparimin dhe përmirësimin e strukturave, mbrojtjen e vizitorëve dhe kafshëve, si dhe garantimin e funksionalitetit dhe estetikës së hapësirës. Rekomandohet respektimi i afateve të planifikuara, përdorimi i materialeve të certifikuara dhe zbatimi i të gjitha masave të sigurisë.

Bashkelidhur DST

Shtojca 9.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

-
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërket për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërket për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkëpunim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Operatorët ekonomikë ofertues duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tyre sipas fushës objekt prokurimi në përputhje me standardet lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë, sistemin e menaxhimit të shëndetit e sigurisë në punë, si dhe sistemin e menaxhimit të mjedisit. Për këtë duhet të paraqesin certifikatat e mëposhtme:

2.1.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 9001 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. Për të vërtetuar këtë kriter duhet të paraqitet certifikata ISO e kërkuar.

2.1.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 14001 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të mjedisit, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. Për të vërtetuar këtë kriter duhet të paraqitet certifikata ISO e kërkuar.

2.1.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 45001 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. Për të vërtetuar këtë kriter duhet të paraqitet certifikata ISO e kërkuar.

2.1.4 Organi i vlerësimit të konformitetit të certifikatave ISO të kërkuara për operatorin ekonomik ofertues duhet të jetë i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë. Për të vërtetuar këtë kriter duhet të paraqitet certifikata e akreditimit përkatëse.

2.1.5 Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë certifikatat ISO të kërkuara janë të detyrueshme për secilin operator ekonomik, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3(tre) viteve të fundit (2022, 2023, 2024) të jetë jo më e ulët se vlera e fondit limit dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2022, 2023, 2024) të certifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-

ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2025 (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar). Për të vërtetuar këtë kriter duhet paraqitur një deklaratë për shlyerjen e detyrimeve vendore ose vërtetimin nga organet e njësisë vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, deklaratën ose vërtetimin nga organet e njësisë vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.

Shënim: Ky kriter (2.2.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, operatori ekonomik ofertues duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a) Përvojë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- b) Përvojë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njerit prej dy kushteve të siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

2.3.2 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të operatorit ekonomik ofertues do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vleresimi per realizimin e punimeve (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i perfundimit te kontrates si dhe natyra e punes se kryer);
- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar shoqëruar me fatura tatimore
- Aktin e kolaudimit;
- Çertifikaten e Perhershme te marrjes ne dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim.

➤ Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontrate Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Aktin e kolaudimit;
- Fatura tatimore perkatese.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet te paraqesë edhe Kontraten e bashkimit te operatoreve shoqeruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku te cilësohen punimet qe ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontratën baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nenkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesi licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjië, në bazë të VKM Nr.42 datë 16.01.2008, (të ndryshuar) e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- **NP-3 A** Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile dhe industriale
- **NS -4 A** Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to etj.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të kete nje numer mesatar te punonjësve të siguar jo më pak se 20 punonjës të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë per muajin e fundit. Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- a. **Vërtetim nga Sigurimet Shoqërore/ose Administrata Tatimore**
- b. **Listëpagesat sipas formës që kërkohet nga legjislacioni në fuqi**

Shënim: Ky kriter (2.3.6) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

2.3.5 Operatorët ekonomikë ofertues, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojnë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si dhe te figurojne ne listepagesa per muajin e fundit , konkretisht si më poshtë:

- **Inxhinier Ndertimi 1 (një)**

Për inxhinieret e mësipërm duhet të paraqitet:

- **Kontratë pune noteriale e vlefshme, Diplomën Universitare.**

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë per punonjesit e mesiperm, emer/mbiemer, profili i punes, numri dhe datë e

kontratës individuale të punës, numri amzes dhe titulli i kualifikimit per diplomën përkatëse, si dhe institucionin qe ka leshuar kete dokument. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar si staf teknik punonjes, te pajisur me Diplomë/certifikate profesionale që vërteton nivelin e kualifikimit profesional, lëshuar nga institucione publike/private, të licencuara/akredituara, te njohur nga Republika e Shqiperise, si dhe te figurojne ne listepagesa per muajin e fundit, si më poshtë vijon;

- 1 (një) punonjës teknik ndertimi
- 1 (një) punonjës teknik topograf
- 2 (dy) punonjës kopshtar
- 5 (pese) punonjës bojaxhi
- 5 (pese) punonjës marangoz
- Kontratë pune e vlefshme,
- Diplomë/certifikate profesionale lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë ose ekuivalente

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë per punonjesit e mesiperm, emer/mbiemer, profili i punes, numri dhe datë e kontratës individuale të punës, numri amzes dhe titulli i kualifikimit per diplomën përkatëse, si dhe institucionin qe ka leshuar kete dokument. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojnë punonjës të specializuar/të kualifikuar, te pajisur me kontrate pune, certifikate/diplome profesionale që vërteton nivelin e kualifikimit, si dhe te figurojne ne listepagesa per periudhen e kerkuar si më poshtë;

- a) 1 (një) punonjes i pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga shoqeri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave. *(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave").*
- b) 1 (një) punonjes i pajisur me çertifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr.10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr.312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave. *(Në rastin e*

Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (nje) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë").

- c) 5 (pesë) punonjës i pajisur me certifikatë “Punime ne Lartesi” që të disponojnë certifikatë trajnimi “Për punime në lartësi”, sipas V.K.M Nr.312 date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqitet certifikata e trajnimit e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të licencuara/akredituara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë per punonjesit e mesiperm, emer/mbiemer, profili i punes, numri dhe datë e kontratës individuale të punës, numri amzes dhe titulli i kualifikimit per diplomën përkatëse, si dhe institucionin qe ka leshuar kete dokument. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

2.3.8 Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues për materialet; rrjete teli që do përdoret për rrethim , boj dhe llak druri per lyerjen e trareve , duhet të paraqesë: Katalogun/ët ose fragmente të katalogut/ëve të prodhuesit/distributorëve zyrtarë ose skedat teknike të publikuara nga prodhuesit/distributorët zyrtarë, ku të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Katalogu ose skeda teknike duhet të përmbajë karakteristikat teknike të mallrave sipas kërkesave të DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse mallrat e ofruara të cilat do të përdoren në kryerjen e shërbimeve, plotësojnë kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Katalogët ose skedat teknike duhet të jenë të noterizuara dhe të përkthyer në gjuhën Shqipe.

2.3.9 Operatori ekonomik ofertues për materialet (Rrjete teli , boj dhe llak druri) të pasqyruara në Shtojcën 6“Formulari i specifikimeve teknike”, që do të përdoren në kryerjen e shërbimeve objekt të kontratës për të cilat kërkohen shprehimisht standarte teknike kombëtare ose ndërkombëtare të publikuara, duhet të paraqesë Deklaratë/Certifikatë Konfirmimit CE ose raporte testimi për këto produkte, të lëshuara nga një organizëm i notifikuar europian / organizëm certifikues i akredituar ose raporte testimi të lëshuara nga organizma të notifikuar europian / organizma testues të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara.

2.3.10 Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë për realizimin e kontratës mjetet teknike dhe pajisjet si më poshtë vijon;

Nr.	Kreu I - Mjetet dhe pajisjet teknike	Sasia minimale	Gjendja
1	Kamion me vinç	1 copë	Në pronësi ose me qira
2	Kamion 3.5 – 5 ton	1 copë	Në pronësi ose me qira
3	Skeleri metalike	500 m2	Në pronësi ose me qira
